

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6210  
E hënë, 11 janar 2021  
çmimi 0.40 €

Vihet në pikëpyetje  
ndarja e 300 eurove  
për punëtorët | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:


[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHXHET SHALA | FAQE 4-5

## AKTGJYKIMI I KUSHTETUESES, POLITIK DHE I SHKRUAR NGA NDËRKOMBËTARËT



Analisti politik Behxhet Shala e ka vlerësuar politik aktgjykimin e Gjykatës Kushtetues i cili disa politikanëve ua ndalon kandidimin për deputet në zgjedhjet e

parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se ky aktgjykim është shkruar nga ndërkombëtarët për qëllime politike

dhe është i paarsyeshëm. Sipas tij, kjo është bërë me qëllim që t'i disiplinojë disa politikanë të cilët ende po shihen jo shumë të pranueshëm për ndërkombëtarët

### OPINION

#### GRUSHTSHTETI I TURPIT DHE SHQIPËRIA | F. 11

Bedri ISLAMI



#### PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS DHE ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME 2021 | F. 11

Shkruan:  
Ismail SYLA



#### IDIOTIZIMI I QËLLIMSHËM I PUBLIKUT | F. 11

Milazim  
KRASNIQI



## ZEMAJ THOTË SE KOSOVA KA SIGURUAR 1 MILION E 220 MIJË VAKSINA KUNDËR COVIDIT | FAQE 7

Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, u ka bërë thirrje të dielën qytetarëve që ta vazhdojnë respektimin e masave kundër përhapjes së Covid-19. Ai ka përmendur rritjet e numrit të të infektuarve në Evropë, por ka thënë se Kosova po vazhdon ta menaxhojë mirë pandeminë. Ministri Zemaj ka bërë me dije se Kosova ka siguruar 1 milion e 220 mijë vaksina kundër Covidit | FAQE 7



### EKONOMI

#### NGA MUJJI SHKURT DO TË FILLOJË TË PAGUHET PJESA TJETËR E SUBVENCIONEVE PËR BUJQIT | F. 8

#### KRYEMINISTRI NË DETYRË: DO TA VAZHDOJMË MBËSHTETJEN E SEKTORIT PRIVAT | F. 8



## HARADINAJ KËRKON NGA QEVERIA NË DETYRË T'I NDAJË FONDET PËR FAMILJET E PREKURA NGA VËRSHIMET | FAQE 3

### SPORT

#### SAN ANTONIO TRIUMFON KUNDËR MINNESOTAS, FITOJNË EDHE DALLASI E MIAMI | F. 12

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Merkeli paralajmëron “javë të vështira” të pandemisë

**BERLIN, 10 JANAR** - Gjermania regjistroi 465 vdekje nga Covid-19 gjatë 24 orëve të fundit ka njoftuar Instituti për Sëmundje Infektive “Robert Koch. Të dielën numri i përgjithshëm i vdekjeve nga koronavirusi, të regjistruara që nga fillimi i pandemisë, kaloi shifrën 40 000. Kancelarja Angela Merkel paralajmëroi se javët e ardhshme do të jenë edhe “më të vështira”.

Më shumë se 1.9 milion njerëz janë infektuar deri më tani në Gjermani. Vetëm të shtunën u raportuan gati 17 000 raste të

reja. Në mesazhin e saj të përjavshëm, Merkel ka pohuar se “javët e ardhshme do të jenë faza më e vështirë e pandemisë”.

Gjermania e kaloi më mirë se shumë vende të tjera evropiane valën e parë të pandemisë në pranverë, por ajo është goditur rëndë nga vala e dytë.

Vendi me 83 milionë banorë ka vendosur masa për t'i kufizuar kontaktet mes njerëzve dhe për t'i ndihmuar spitalet ta përballojnë një rritje të numrit të pacientëve.

Më shumë se 5 000 pacientë me Covid-19 janë aktualisht në kujdes intensiv në të gjithë vendin, me mbi 80 për qind të shtretërve të kujdesit intensiv të zënë.

Gjermania ka mbyllur shkollat dhe dyqanet jothelbësore, mjediset e kulturës dhe ato të kohës së lirë deri të paktën më 31 janar me shpresën për ta ngadalësuar përhapjen. Ashtu si vendet e tjera të BE-së, ajo filloi t'i vaksinon qytetarët kundër Covid-19 në fund të dhjetorit me vaksinën “Pfizer/BioNTech”.



## Pence pritet të marrë pjesë në inaugurimin e Bidenit

**NJU-JORK, 10 JANAR** - Zëvendëspresidenti amerikan Mike Pence pritet të marrë pjesë në inaugurimin e presidentit të zgjedhur Joe Biden, raportoi agjencia “Reuters”, duke u thirrur në deklaratën e një zyrtari të lartë të administratës amerikane të cilin nuk e identifikoi. Pence nuk iu përgjigj thirrjes së presidentit aktual Donald Trump për ta kundërshtuar certifikimin e votave të Kolegjit Elektoral nga ana e Kongresit. Një turmë mbështetësish të dhunshëm të Trumpit sulmuan Kongresin të mërkurën në përpjekje për ta ndaluar procedurën e certifikimit. Nga trazirat mbetën pesë persona të vdekur.



Presidenti i zgjedhur, Joe Biden, ka thënë se Pence do të ishte i mirëpritur në betimin e tij zyrtar më 20 janar. “Ne do të ishim të nderuar ta kemi atë atje dhe të ecim përpara në

tranzicion”, ka thënë Biden. Në postimin e fundit, para se llogaria e tij të hiqej përgjithmonë nga “Twitter”, Trump ka thënë se nuk do të merrte pjesë në inaugurim.

## Pompeo: ShBA-ja do t'i shfuqizojë kufizimet në kontaktet me Tajvanin

**NJU-JORK, 10 JANAR** - ShBA-ja po heq kufizimet në kontaktet midis zyrtarëve amerikanë dhe tajvanëzë. Kështu ka thënë sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo. Kufizimet u vendosën dekada më parë për të “qetësuar” qeverinë kineze, e cila ka pretendime për ishullin, ka njoftuar departamenti i Shtetit i ShBA-së në një deklaratë.

Këto rregulla tani janë “të pavlefshme”, thuhet në deklaratë. Masa ka të ngjarë të zemërojë Kinën dhe të rrisë tensionet midis Uashingtonit dhe Pekinit. Vendimi u mor derisa administrata e presidentit aktual të ShBA-së, Donald Trump hyn në ditët e saj të fundit, përpara inaugurimit të Joe Biden si president më 20 janar. Ekipi i tranzicionit i Bidenit ka thënë



se presidenti i zgjedhur është i përkushtuar për të ruajtur politikën e mëparshme të ShBA-së ndaj Tajvanit. Sipas BBC-së, analistët thonë se administrata e re do të jetë e pakënaqur me një vendim të tillë politik që po merret në ditët e fundit të administratës Trump, por që masa mund të anulohet lehtësisht nga pasardhësi i Pompeo, Antony Blinken.

## Tërmeti godet Vanuatun në Unazën e Zjarrit

**NJU JORK, 10 JANAR** - Një tërmet ka goditur Vanuatu që ndodhet pranë Unazës së Zjarrit në Oqeanin Paqësor. Kjo është një zonë me aktivitet të lartë sizmik, duke shkaktuar shpërthime të rregullta vullkanike dhe tërmete. Sipas

Shërbimit Gjeologjik të Shteteve të Bashkuara (USGS), një tërmet me magnitudë 6 ka goditur 49 km në lindje të Lakatoro, Vanuatu dhe 194 kilometra në veriperëndim të kryeqytetit të vendit ishull Port Vila.

Epiqendra ishte në një thellësi prej 160 kilometrash. Asnjë paralajmërim për tsunami nuk është lëshuar nga autoritetet deri më tani. Gjithashtu nuk ka pasur raporte për dëme ose viktima të shkaktuara nga dridhja.

## Autoritetet e Shqipërisë shpëtojnë 55 migrantë të bllokuar në det

**Tiranë, 10 janar** - Autoritetet shqiptare kanë evakuuar 55 migrantë sirianë pasi ishin bllokuar për orë të tëra në ujërat e ashpër në detin Adriatik në një përpjekje për të arritur në Itali. Sirianët, përfshirë gratë dhe fëmijët, u bllokuan nga moti i keq për më shumë se tri orë në një anije jashtë vijës bregdetare të Adriatikut të Shqipërisë. “Operacioni i shpëtimit dhe

evakuimi i njerëzve u zhvillua në kushte shumë të këqija në mes të një stuhie dhe valësh të larta në det”, thuhet në deklaratën e policisë së Shqipërisë. Gjashtëmbëdhjetë nga pasagjerët e anijes, përfshirë tre fëmijë, u shtruan në spital, ndërsa të tjerët pritet të dërgohen në një qendër migrantësh. Shqipëria është një vend kryesor tranzit për shumë

migrantë dhe refugjatë nga Azia, Afrika dhe Lindja e Mesme të cilët po përpiqen të arrijnë në Evropën Perëndimore përmes rrugës Ballkanike. Pavarësisht nga pandemia, numri i migrantëve që kalojnë nëpër Shqipëri është trefishuar në vitin 2020 krahasuar me një vit më parë, tregojnë të dhënat e policisë.



# 'Daja' përkrah Lladrovcin edhe për një mandat në krye të Drenasit

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

DRENAS, 10 JANAR- Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur të dielën në shtëpinë e vet Azem Syën, i njohur si 'Daja', Sejdi Hoxhën dhe Labinot Halilajn. Lladrovci përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka falënderuar Azem Syën, Sejdi Hoxhën dhe Labinot Halilajn për vizitën dhe përkrahjen me rastin e nominimit të tij për kryetar të Komunës së Drenasit në mandatin e ardhshëm. Ai ka thënë se Drenica gjithmonë ka qenë dhe është bashkë kur bëhet fjalë për interesin kombëtar. "Falënderoj Azem Syën, Sejdi Hoxhën dhe Labinot Halilajn për vizitën dhe përkrahjen me rastin e

nominimit tim për kryetar të komunës në mandatin e ardhshëm. Kjo përkrahje ka kuptim në funksion të mirëqenies së qytetarëve, përmirësimit të kushteve të jetës për qytetarët tanë, duke e bërë datën 14 shkurtin, datë të festës për votën e fuqishme të qytetarëve të komunës tonë dhe Drenicës për PDK-në.

Djepi i UÇK-së, Drenica, vatra e luftës dhe çlirimit, është rritur në nivel nacional falë unitetit tonë, duke u identifikuar pas çlirimit si bastion i PDK-së", ka thënë Lladrovci. Ai ka shtuar se edhe sot, ashtu siç e ka potencuar më herët, do të jenë unik, si asnjëherë më parë sepse, sipas Lladrovcit, vizioni i PDK-së për fuqizimin e shtetit, për zbatimin e ligjit dhe mundësive të barabarta, janë



frymëzimi i tyre. "Dhimbja jonë, nga 6 nëntori 2020, është e lidhur me ndalimin e padrejtë të liderëve tanë në Hagë, andaj

përkushtimi ynë për fitore do të jetë i motivuar më shumë se çdoherë në Kosovën e lirë dhe kauzat e udhëheqësve tanë drejt

çlirimit dhe fuqizimit të shtetit. Uniteti ynë ka qenë dhe është çelësi i fitores!", ka thënë kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci.

## Haradinaj kërkon nga qeveria në detyrë t'i ndajë fondet për familjet e prekura nga vërshimet

EPOKA  
ERE

Faton Dërmaku

PRISHTINË, 10 JANAR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka vizituar të dielën Komunën e Malishevës, një ndër zonat e prekura nga vërshimet. Haradinaj ka thënë se në këtë katastrofë natyrore të gjithë së bashku duhet të qëndrojmë pranë familjeve të prekura dhe të bashkëndiejmë me vuajtjet e tyre nga këto përmbytje. "Ftoj qeverinë në detyrë për mobilizim të menjëhershëm të të gjitha institucioneve përkatëse me qëllim të ndihmës dhe përkrahjes për qytetarët, si dhe të vendosë për ndarjen e fondit emergjent për mbështetjen e menjëhershme të të gjitha familjeve të prekura nga këto përmbytje", ka thënë ai. Haradinaj ka theksuar se dëmet infrastrukturore nga këto

përmbytje mund të jenë edhe si pasojë e punëve të shpejta dhe jocolësore. "Të gjithë duhet të mbajnë përgjegjësi nëse nuk i kanë përbushur kontratat sa i përket cilësisë së punës. Ngritja e standardeve të larta infrastrukturore si dhe kapaciteteve për reagim dhe mbrojtje nga katastrofat natyrore duhet të jetë prioritet i shtetit tonë. Njëkohësisht ftoj aktivistët, strukturat e Aleancës në zonat e prekura si dhe të gjithë qytetarët e vullnetit të mirë, që t'iu dalin në ndihmë familjeve të prekura në këtë fatkeqësi natyrore", ka thënë kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj.


Reshjet e mëdha të shiut gjatë ditëve të fundit kanë shkaktuar vërshime në disa pjesë të Kosovës. Reshjet e dendura të shiut kanë përfshirë Malishevën, Drenasin, Fushë-Kosovën, Gjakovën, Rahovecin dhe Suharekën.

## Nga sot reshjet e shiut dhe të borës do të jenë me intensitet më të dobësuar

PRISHTINË, 10 JANAR (ER) - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka njoftuar për parashikimin e motit për pesë ditët e ardhshme në vendin tonë. Sipas IHK-së, situatë e paqëndrueshme meteorologjike do të vazhdojë edhe për këto pesë ditë të parashikimit. "Në fushat barike do të ketë luhate me tendencë të rritjes, derisa

në fushat termike pritet rënie në të dy vlerat ekstreme. Reshjet e shiut dhe të borës të cilat tani po bien, do të vazhdojnë edhe gjatë natës së diel, por nga dita e hënë reshjet do të jenë me intensitet më të dobësuar. Sasitë e reshjeve për momentin më intensive janë në Dukagjin, kurse në juglindje dhe në lindje të vendit sasitë e

reshjeve janë dyfish më pak. Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet -5 deri 0 gradë celsius, ndërsa maksimalet e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 1-3 gradë celsius. Do të fryjë erë nga jugperëndimi dhe veriperëndimi me shpejtësi 1-7m/s", ka njoftuar Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.





FLET PËR “EPOKËN E RE”, BEHXHET SHALA

# AKTGJYKIMI I KUSHTETUESES, POLITIK DHE I SHKRUAR NGA NDËRKOMBËTARËT

Analisti politik Behxhet Shala e ka vlerësuar politik aktgjykimin e Gjykatës Kushtetues i cili disa politikanëve ua ndalon kandidimin për deputet në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se ky aktgjykim është shkruar nga ndërkombëtarët për qëllime politike dhe është i paarsyeshëm. Sipas tij, kjo është bërë me qëllim që t’i disiplinonjë disa politikanë të cilët ende po shihen jo shumë të pranueshëm për ndërkombëtarët

gazetës “Epoka e re”, Shala ka deklaruar se kjo është bërë për të dërguar porosi te disa politikanë. “Aktgjykimin i Kushtetueses, për mendimin tim, është politik dhe i shkruar nga ndërkombëtarët. Pra, ndërkombëtarët e kanë shkruar këtë vendim në emër të Gjykatës Kushtetuese. Për mua ky vendim është politik dhe i paarsyeshëm. Për shkak të votës së z. Arifi është dashur që procesi të rikthehet në pikën zero e jo ta dërgojë vendin në zgjedhje, sepse Kushtetuesja nuk ka mandat ta çojë vendin në zgjedhje”, ka thënë Shala. Sipas tij, është e padrejtë që Albin Kurtit, Albulena Haxhiut, Donika Kadaj-Bujupit dhe Faton Topallit të mos u lejohet

të kandidojnë për deputetë. Ai ka thënë se kjo paraqet shkelje të drejtave të njeriut. “Me këtë vendim ndërkombëtarët dëshirojnë t’u dërgojnë porosi disa personave të cilët ende nuk po shihen shumë të pranueshëm për ta. Për mua nuk ka asnjë dyshim se ky vendim është shkruar nga ndërkombëtarët”, është shprehur Shala. Në këtë intervistë Shala ka folur edhe për rezultatin që mund ta marrin subjektet politike më 14 shkurt. Ai ka thënë se fryma ekziston që Lëvizja Vetëvendosje të fitojë në këto zgjedhje por, sipas tij, ky subjekt politik nuk do të fitojë aq sa mendon lideri i saj. Shala ka thënë se PDK-ja dhe

LDK-ja nuk mund të bien nën 20 deputetë. “Nuk besoj në asnjë variant se PDK-ja dhe LDK-ja mund të bien nën 20 deputetë. Pra, jam i sigurt se nëse LDK-ja nuk e bën asnjë ditë fushatë në zgjedhje, vetëm në sajë të strukturës së saj, ajo nuk bie nën 20 deputetë, sikurse që as PDK-ja që nuk mund të bie nën 20-22 deputetë. Pra, në variantin më të keq, LDK-ja dhe PDK-ja nuk mund të bien nën 45 deputetë”, ka thënë Shala.

**“Epoka e re”:** Z. Shala, pas publikimit të Aktgjyimit të Kushtetueses, partitë politike jozyrtarisht kanë filluar fushatën zgjedhore. Si i keni parë këto veprime të tyre?  
**Shala:** Partitë politike kanë

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 10 JANAR - Analisti politik Behxhet Shala e ka kritikuar aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese i cili disa

politikanëve ua ndalon të garojnë për deputet në zgjedhjet e reja parlamentare më 14 shkurt. Ai ka thënë se ky aktgjykim është politik dhe i shkruar nga ndërkombëtarët. Në këtë intervistë dhënë

qenë në fushatë edhe para aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, sepse e kanë pasur të qartë se kjo qeveri nuk mund të zgjasë shumë për shkak të zgjedhjes së presidentit. Ndërsa aktgjykimi i Kushtetueses, për mendimin tim, është politik dhe i shkruar nga ndërkombëtarët. Pra, ndërkombëtarët e kanë shkruar këtë vendim në emër të Gjykatës Kushtetuese. Për mua ky vendim është politik dhe i paarsyeshëm. Për shkak të votës së z. Arifi është dashur që procesi të rikthehet në pikën zero e jo ta dërgojë vendin në zgjedhje, sepse Kushtetuesja nuk ka mandat ta çojë vendin në zgjedhje. Është e padrejtë që Albin Kurtit, Albulena Haxhiut, Donika Kadaj-Bujupit dhe Faton Topallit t'u ndalohet kandidimi për deputetë. Është një vendim politik, i cili, në thelb, i shkel të drejtat e njeriut për të votuar dhe për të qenë i votuar.

**“Epoka e re”:** Pse mendoni se këtë vendim e kanë marrë ndërkombëtarët?

**Shala:** Me këtë vendim ndërkombëtarët dëshirojnë t'u dërgojnë porosi disa personave të cilët ende nuk po shihen shumë të pranueshëm për ta. Për mua nuk ka asnjë dyshim se ky vendim është shkruar nga ndërkombëtarët. Pra, ky vendim u dërgon disa porosi të gjithë politikanëve dhe si i tillë

vendimi në të ardhmen mund të ndikojë në profilizimin e skenës politike të Kosovës. Porositë e këtij vendimi janë se disa politikanë ende duhet të zbuten dhe të bëhen të pranueshëm nga ndërkombëtarët.

**“Epoka e re”:** Deri më tani ende nuk kemi ndonjë zyrtarizim të koalicioneve parazgjedhore. Prisni ndonjë befasi në këtë drejtim. Është i mundëm që krahu i luftës të bashkohet sërish?

**Shala:** Tani nuk kemi krah të luftës e të paqes, sepse gjatë proceseve disa parti janë profilizuar vetvetiu, e disa parti i ka profilizuar zhvillimi i ngjarjeve. E dini se më parë subjektet e mëdha politike kanë bërë përpjekje që rreth vetes të mbledhin sa më shumë subjekte politike, ndërsa tani kanë ndryshuar gjërat. Tani kemi një situatë që AKR-ja të jetë pjesë e listës së LDK-së dhe nuk do të kemi ndonjë koalicion si më herët. Edhe Lëvizja Vetëvendosje ka deklaruar se nuk do të pranojë që të ketë ndonjë koalicion parazgjedhor, sikurse edhe PDK-ja që deri më tani ka refuzuar të bëjë ndonjë koalicion me partitë e vogla por, thjesht, i ka ofruar mundësinë që të garojë në kuadër të listës së saj. Sa kam parë, edhe AAK-ja ka deklaruar se do të shkojë e vetme në

zgjedhje. Kjo po ndodh sepse në koalicionet parazgjedhore të partive të mëdha me të vogla, po humbin partitë e mëdha dhe po fitojnë ato të voglat, të cilat po të hynin të vetme në zgjedhje nuk do ta kalonin pragun zgjedhor. Deri më tani si enigmë ka mbetur Nisma, e cila po llogarit se mund t'i fitojë rreth 55 mijë vota që do t'i mjaftonin ta kalojë pragun. Por, unë ende i kam dilemat e mia nëse kjo parti do t'i marrë ato vota. Pra, deri më tani është një gatishmëri e partive të mëdha që të mos hyjnë në koalicione me partitë e vogla.

**“Epoka e re”:** Tri partitë e mëdha pretendojnë se do të jenë të parat në këto zgjedhje. Kush mendoni se do t'i fitojë zgjedhjet e 14 shkurtit?

**Shala:** Tani është një frymë e cila e nxjerr Lëvizjen Vetëvendosje fituese të zgjedhjeve. Kështu mendoj edhe unë. Por, kjo nuk është prognoza ime përfundimtare, sepse unë do të dal, siç kam bërë deri më tani me prognozën time në gazetën “Epoka e re” para zgjedhjeve. Do ta jap mendimin tim se cili do të jetë rezultati i zgjedhjeve të 14 shkurtit. Nuk e shoh LV-në në ato shifrat që po i thotë se do t'i fitojë mbi 60 për qind. Mendoj se ato shifra janë joserioze, sepse nuk mund të arrihen. Nuk besoj në asnjë

variant se PDK-ja dhe LDK-ja mund të bien nën 20 deputetë. Pra, jam i sigurt se nëse LDK-ja nuk e bën asnjë ditë fushatë në zgjedhje, vetëm në sajë të strukturës së saj, ajo nuk bie nën 20 deputetë, sikurse që as PDK-ja që nuk mund të bie nën 20-22 deputetë. Pra, në variantin më të keq LDK-ja dhe PDK-ja nuk mund të bien nën 45 deputetë. Kurse për AAK-në jam i sigurt se do ta kalojë pragun dhe pretendimet se kjo parti nuk mund ta kalojë pragun, për mendimin tim, nuk janë serioze. Besoj se në variantin më të keq, AAK-ja nuk do të ketë më pak se 12 deputetë, ndoshta mund të ketë më shumë, por jo më pak. Kjo parti pretendon se pas zgjedhjeve do të jetë një përcaktuese për formimin e koalicionit qeverisës.

**“Epoka e re”:** Në këtë parafushatë zgjedhore partitë vetëm kanë filluar të bëjnë pretime të ndryshme. Besoni se do të arrijnë t'i përmbushin ato pretime?

**Shala:** Jam i bindur se asnjë parti politike nuk do të mund t'i përmbushë premtimet që i jep gjatë fushatës, sepse pandemia e ka shkaktuar një krizë të thellë ekonomike në Kosovë. Gjithashtu, pengesa kryesore në mospërmbushjen e premtimeve do të jenë bisedimet me Serbinë.

## IDIOTIZIMI I QËLLIMSHËM I PUBLIKUT

Kur qytetarët në mënyrë intuitive e dinë cili është interesi strategjik i vendit, ndërsa votojnë kundër atij interesi, i bie që ka triumfuar në kokat e tyre propaganda antishtetërore. Ka triumfuar strategjia për uljen e aftësisë së tyre për të gjykuar drejt



Milazim KRASNIQI

Përgjithësimet e akuzave ndaj disa partive (PDK e LDK dhe Lista e Vjosa Osmanit, në rend të parë), gjë që është bërë si ritual i disa individëve/grupeve/qarqeve propagandistike në Kosovë, tregojnë shkallë të lartë të tendencës për idiotizimin e qël-

limshëm të komunikimit dhe të publikut.

Idiotizim i qëllimshëm është veprimi që bëhet nga propagandistë që nuk janë idiotë, por veprojnë si idiotë, nga dëshira që t'i shkaktojnë ndokujt ndonjë dëm dhe ashtu të përfitojnë ndonjë dobi nga dëmi që bëjnë. Kjo prirje po bëhet shumë viruente tek ata që kanë marrë përsipër ta manipulojnë publikun dhe votuesin në Kosovë. Po lëviz drejt shndërrimit në një lloj epidemie për zgjedhjet e radhës. Në kryshin idiotizues që kanë marrë disa grupe e qarqe, tashmë pothuajse e kanë eliminuar

çdo barrikadë morale dhe çdo preokupim me të vërtetën. Këto grupe dhe qarqe, në mesin e të cilëve ka edhe njerëz të fesë(!), qëllimisht veprojnë si idiotë, duke synuar me çdo kusht dobishmërinë për vete dhe me çdo kusht dëmin për viktimat e propagandës së tyre. Mungesa te këto grupe dhe qarqe e çfarëdo kufiri moral dhe mungesa e çfarëdo preokupimi për të vërtetën, prodhon një ligjërim të shfrenuar dhe prodhon pamje halucinante në komunikimin në sferën publike. Ligjërimi i shfrenuar (shpifës, denoncues) dhe pamjet halucinante i servohen publikut, me qëllim që ta dezorientojnë, ta paafësojnë që të veprojnë moralisht dhe që të mos arrijnë ta njohin të vërtetën. Në këtë aspekt, viktimitë më e madhe është vetë publiku, se sa objektet e

këtyre sulmeve, në këtë rast disa nga partitë politike (PDK e LDK dhe Lista e Vjosa Osmanit, në rend të parë.) Objektet e sulmuara me këtë model propagande e lufte speciale, mund të dëmtohen deri diku, por ato edhe i mbijetojnë sulmet, falë organizimeve të brendshme reaktive dhe kundërsulmeve që mund të organizojnë edhe vetë. Ndërsa, publiku është viktimitë e sigurt, sepse ai helmohet me të pavërtetat, indoktrinohet, histerizohet dhe merce-narizohet, duke punuar/votuar edhe në dëm të vetvetes. Fjala vjen, nëse publiku, në rolin e votuesit, si pasojë e këtij manipulimi, voton për forca politike që mund ta përkeqësojnë pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe të ftohien marrëdhëniet e saj me sponsorët e pavarësisë së saj, kjo haptas është në dëm të vetë atij pub-

liku/votuesi. Pse? Sepse, Kosova është bërë shtet vetëm falë sponsorëve të saj (SHBA dhe NATO) dhe pa ndihmën e tyre nuk mund të mbijetojë si shtet. Pra, interes absolut i publikut votuesve/shtetasve duhet të jetë ruajtja e raporteve strategjike me SHBA-në dhe NATO-n. Këtë qytetarët e dinë, në mënyrë intuitive. Por, kur qytetarët në mënyrë intuitive e dinë cili është interesi strategjik i vendit, ndërsa votojnë kundër atij interesi, i bie që në kokat e tyre ka triumfuar propaganda antishtetërore. Ka triumfuat strategjia për uljen e aftësisë së tyre për të gjykuar drejt. Pra, ka triumfuat idiotizimi i qëllimshëm. Ky edhe është caku që aspirojnë të arrijnë çdo propagandë agresive dhe e zhveshur nga kufizimi moral dhe nga preokupimi me të vërtetën. (10 janar 2021)

# Vendimi i Kushtetueses “nuk e pastron” politikën

PRISHTINË, 10 JANAR - Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese që ua ndalon kandidimin për deputet personave të dënuar për veprë penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë në tre vjetët e fundit, po shihet si politik dhe joefikas për ta dekriminalizuar skenën politike në Kosovë.

Ndër të dënuarit në tre vjetët e fundit janë edhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, si dhe deputetët Albulena Haxhiu, Faton Topalli dhe Donika Kadaj-Bujupi. Ata u dënuan me kusht më 3 janar 2018 për hedhjen e gazit lotsjellës në ambientet e Kuvendit të Kosovës.

Sipas Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), ky vendim i Kushtetueses prek vetëm një pjesë të vogël, por jo edhe të gjithë personat zyrtarë e politikanët që janë të akuzuar për vepra penale korruptive.

Si i tillë, Miftaraj thotë për “Radion Evropa e Lirë” se ky vendim nuk mund t’i largojë nga skena politike personat që janë të dënuar dhe që kanë aktakuza.

“Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese mund të themi se prek një numër shumë të kufizuar, shumë të vogël të personave (të politikës). Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese nuk është se do të bëjë ndonjë diferencë të madhe, nuk është që do të bëjë dekriminalizimin e skenës politike në Kosovë”, ka thënë Miftaraj.

Ai ka theksuar se partitë politike duhet të miratojnë dokumente, përmes të cilave e pastrojnë skenën politike, në çdo rast kur një person është i akuzuar apo ka probleme me ligjin. Sipas tij, në këtë mënyrë jo vetëm Kuvendi, por edhe institucionet e tjera ekzekutive do të pastroheshin nga persona që kanë probleme me ligjin.

## Vendim me motive politike

Drejtoresha e Grupit për Studime Politike dhe Juridike, Arbresha Loxha, ka theksuar për “Radion Evropa e Lirë” se vetingu apo dekriminalizimi i politikës nuk mund të bëhet me parametra arbitrare. Aktgjykimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese, sipas saj, është politik. “Ne konsiderojmë që vetëm përcaktimet e qarta objektive mund t’i kontribuojnë pastërtisë së Kuvendit dhe jo përcaktimet e përkohshme dhe me motive të qarta politike, siç është rasti i aktgjykimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese”, është shprehur ajo. Loxha ka pohuar se duhet të bëhet dallimi i veprave penale, e një gjë të tillë, sipas saj, nuk e ka bërë Gjykata Kushtetuese. “Konsiderojmë se kufizimi i së drejtës për të kandiduar nuk do të duhej dhe nuk mund të bëhet ashtu ‘blanko’, pavarësisht nëse personi që do të kandidohet është i dënuar për ndonjë krim



serioz apo për veprë penale që ka rrjedhur nga pakujdesia apo veprimi opozitar politik”, ka thënë Loxha.

## Gjykata Kushtetuese në rol tjetër

Ehat Miftaraj nga IKD-ja thotë se Gjykata Kushtetuese me këtë vendim ka bërë përpjekje për t’i përmirësuar gabimet e gjykatave të rregullta. Sipas tij, gjykatat nuk kanë guxim që t’i gjykojnë dhe dënojnë zyrtarët politikë, për t’ua kufizuar të drejtën e kandidimit me vendime gjyqësore.

Nëse kjo nuk ndodh, Miftaraj thotë se kjo praktikë do të

vazhdojë edhe në të ardhmen. “Në bazë të ligjit të aplikueshëm në Kosovë, në bazë të nenit 45 të Kushtetutës, gjykatat e Kosovës në çdo rast kur gjykojnë dhe dënojnë politikanë, zyrtarë publikë, e kanë mundësinë që përmes dënimit plotësues, t’ua kufizojnë të drejtën për të ushtruar funksione publike për një periudhë të caktuar kohore”, ka deklaruar Miftaraj. Aktgjykimi i plotë prej 65-faqesh i Gjykatës Kushtetuese, lidhur me zgjedhjen jokushtetuese të Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga Avdullah Hoti, u publikua më 6 janar të këtij viti. Lëvizja Vetëvendosje e kishte

dërguar në Kushtetuese çështjen lidhur me kushtetutshmërinë e votimit të qeverisë Hoti për shkak se për këtë qeveri më 3 qershor kishte votuar Etem Arifi, i dënuar me vendim të formës së prerë prej më shumë se një vit burgim për veprën penale “mashttrim me subvencione”.

Vota e tij ishte vendimtare për formimin e qeverisë së drejtuar nga Avdullah Hoti i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, ka shpallur zgjedhjet e reja parlamentare të cilat do të mbahen më 14 shkurt.

# PDK-ja themeloi degët edhe në Kanada dhe në Finlandë

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 JANAR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) po vazhdon themelimin dhe zgjerimin e degëve të saj nëpër botë. Tashmë kjo parti ka themeluar edhe dy degë në Finlandë dhe Kanada. Drejtori i Departamentit për Diasporë në PDK, Elmi Reçica, ka mbajtur takime virtuale me anëtarët e PDK-së në Finlandë dhe Kanada, me ç’rast janë pajtuar për konstituimin e këshillave nismëtarë për themelimin e degëve në Helsinki dhe Toronto. “Në kuadër të rikthimit të aktiviteteve politike të Partisë Demokratike të Kosovës në diasporë, në koordinim me Departamentin për Çështje të



Diasporës, sot në Helsinki dhe Toronto u konsoliduan këshillat nismëtarë për themelimin e degës së PDK-së në Finlandë. Duke e parë manipulimin e opinionit të diasporës për të vërtetën e

Kosovës, jemi obliguar që të riorganizohemi për të paraqitur të vërtetën e Kosovës ashtu siç është”, ka thënë Reçica.

Drejtes të degës në Finlandë u caktuan veprimtarët e

shquar Miftar Miftari, Bashkim Thaçi dhe Dren Koci me qendër në Helsinki. Ndërsa në Kanada, këshillin nismëtar do të udhëheqin Ridvan Pacolli dhe Ylla Ibra me qendër në Toronto. “Partia

Demokratike e Kosovës në kuadër të platformës dhe vizionit politik ka marrë vendime për diasporën që, me kryeministrin në ardhje, Enver Hoxhaj, do t’i realizojmë zotimet për diasporën, duke përfshirë vende në listën e PDK-së për deputetë, rikthimin e ministrisë së Diasporës, ulëse të rezervuara në Kuvendin e Kosovës si dhe duke e bërë pjesë aktive dhe konkrete të zhvillimit dhe shtetndërtimit të Kosovës. Falënderim dhe respekt i veçantë për të gjithë pjesëmarrësit në këto takime nismëtare për themelimin e degëve si dhe për kontributin e madh në të gjitha fazat dhe proceset nëpër të cilat ka kaluar vendi për arrijten e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës”, ka thënë Reçica.

# Zemaj thotë se Kosova ka siguruar 1 milion e 220 mijë vaksina kundër Covidit

Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, u ka bërë thirrje të dielën qytetarëve, që të vazhdojnë respektimin e masave kundër përhapjes së Covid-19. Ai ka përmendur situatën me rritjen e numrit të të infektuarve në Evropë, por ka thënë se Kosova po vazhdon ta menaxhojë mirë gjendjen me pandeminë. Ministri Zemaj ka bërë me dije se Kosova ka siguruar 1 milion e 220 mijë vaksina kundër Covidit



EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 JANAR - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije të dielën se Kosova ka arritur të sigurojë 1 milion e 220 mijë vaksina kundër Covidit. "Ju siguroj qytetarë të vendit tim, se tashmë kemi siguruar 1 220 000 vaksina kundër Covidit. Deri në arritjen e vaksinave të vazhdojmë t'i respektojmë masat, të mos i ngarkojmë institucionet shëndetësore", ka shkruar ministri Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka falënderuar qytetarët për bashkëpunimin e deritanishëm që kanë treguar me institucionet e vendit për respektim të masave kundër Covidit. "Ju ftoj që edhe më tej të vazhdojmë bashkë luftën kundër Covid-19. Jam përpjekur maksimalisht që kuadrit profesional dhe shumë të përkushtuar t'i shtohen 1 500 specialistëve, punësimin e të gjithë mjekëve të papunë, si dhe shtimin e personelit shëndetësor për 608 punonjës. Kuadri profesional ka gjetur angazhim të plotë në sistemin shëndetësor të vendit dhe largimi i mjekëve nga Kosova është zvogëluar shumë duke gjetur këtu perspektivën", ka shkruar ministri Zemaj.

Ministri Zemaj ka përmendur situatën me rritjen e numrit të të infektuarve në Evropë, por ka thënë se Kosova po vazhdon ta menaxhojë mirë gjendjen me pandeminë. "Qytetarë të nderuar, respektoni masat kundër Covidit. Përderisa të gjitha shtetet evropiane janë duke u përballur me numër të madh të pacientëve të infektuar me Covid-19, vendi ynë suksesshëm po vazhdon ta menaxhojë situatën epidemiologjike në vend. Nga 1 586 mostra të marra brenda 24 orëve, 253 kanë rezultuar pozitive, 646 kanë fituar betejën me Covid-19, ndërsa kemi dy vdekje", ka shkruar Zemaj.

## Edhe dy të vdekur dhe 253 raste të reja me Covid në Kosovë

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 1 586 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në

terren, prej të cilave kanë rezultuar 253 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar dy raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e vdekjes janë nga komunat: Mitrovicë një rast (82 vjeç), Prishtinë një rast (66 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 53 776 raste nga 197 061

persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 377 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 646 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 46 259 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 140. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 93 raste, Podujevë 31 raste, Mitrovicë

23 raste, Vushtrri 16 raste, Fushë-Kosovë 14 raste, Viti 11 raste, Gjilan 10 raste, Ferizaj 8 raste, Lipjan 8 raste, Malishevë 7 raste, Obiliq 6 raste, Suharekë 6 raste, Skenderaj 5 raste, Kaçanik 3 raste, Istog 2 raste, Rahovec 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Deçan, Drenas, Gjakovë, Kamenicë, Prizren dhe Shtërpcë.

## Në Klinikën e Pediatriisë u trajtuan mbi 70 fëmijë të prekur me Covid-19

PRISHTINË, 10 JANAR - Në njësinë për trajtimin e pacientëve me Covid-19 në kuadër të Klinikës së Pediatriisë deri në mesin e dhjetorit që lamë pas janë trajtuar 71 fëmijë, kryesisht të gjithë e kaluan këtë virus me simptoma të lehta. Luftën me Covidin e ka humbur vetëm një fëmijë i cili kishte edhe sëmundje të tjera shoqëruese. Drejtoresha e Klinikës së Pediatriisë, Drita Telaku, ka treguar se fëmijët që po infektohen me Covid-19 janë

duke kaluar me simptoma të lehta dhe nuk po kanë nevojë për trajtim spitalor. "Fatmirësisht numri i fëmijëve të prekur me Covid-19 është relativisht i vogël. Numri më i madh i tyre (fëmijëve të infektuar) po e kalojnë me pak simptoma. Shumë shpesh nuk po ka nevojë fare të kërkojnë ndihmë mjekësore. Mirëpo, përkundër asaj, kemi fëmijë të cilët kanë kërkuar hospitalizim. Në kuadër të Klinikës së Pediatriisë kemi



formuar njësinë e posaçme e cila merret me mjekimin e

fëmijëve me Covid-19. Në këtë njësi është caktuar stafi

që punon si infermier ashtu dhe i mjekëve. Deri në mesin e dhjetorit në Klinikën tonë kanë qenë 71 pacientë të prekur me Covid që kanë kërkuar hospitalizim. Fatmirësisht shumica e tyre kanë një ecuri të mirë, mirëpo kanë pasur nevojë për mjekim spitalor. Prej të gjithë fëmijëve të infektuar me Covid-19 që kemi pasur, një fëmijë ka përfunduar me vdekje, i cili ka qenë me një sëmundje të rëndë kronike", ka thënë Telaku, raporton ksp.

# Vihet në pikëpyetje ndarja e 300 eurove për punëtorët

PRISHTINË, 10 JANAR - Ende nuk ka filluar ndarja e 300 eurove për tre muaj për punëtorët të cilët kanë humbur vendin e punës gjatë periudhës së pandemisë me Covid-19 ashtu siç parashihet me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Sipas Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, është paraparë që nga buxheti i Kosovës të paguhet pagat e punonjësve në sektorin privat për periudhën tetor-dhjetor 2020 të cilët si pasojë e pandemisë Covid-19 janë larguar apo pezulluar nga puna për periudhën jo më të shkurtër se tre muaj, pas datës 29 shkurt e deri më 30 dhjetor 2020.

Por, ndarja e këtyre mjeteve mund të mos bëhet në mungesë të mjeteve financiare.

Zëvendësministri në detyrë i Financave, Agim Krasniqi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se amendamenti i këtij ligji nuk është mbuluar me mjete financiare në buxhetin e miratuar të Kosovës për vitin 2021.

"Deklarimet që janë bërë para se të miratohet buxheti për vitin 2021, se do të shtohen 200 milionë euro për bizneset dhe 25 milionë euro për punëtorët, nuk janë ndryshuar (nuk janë përfshirë në buxhet). Në draftbuxhetin aktual është një shifër prej 182 milionë eurosh, ku përfshihen sektori i biznesit, punëtorët, një pjesë është për shëndetësi, një pjesë për fondin për garantim të kredive. Nga kjo shumë rreth 106 milionë do të ndahen për bizneset dhe punëtorët", thotë Krasniqi.

Për ndarjen e këtyre mjeteve, Krasniqi thotë se ende nuk ka vendim nga Qeveria e Kosovës i cili do të mundësonte shpërndarjen e këtij fondi.

Por, sipas Krasniqit, në këtë shpërndarje nuk mund të flitet as për 300 euro as për ndonjë

shifër tjetër. "Duhet të pritet vendimi i qeverisë i cili do të përcaktojë se si do të bëhet ndarja, për cilat kategori dhe sa duhet të jetë shuma që ndahet", thotë ai.

Krasniqi beson se javën e ardhshme do të merret vendimi i përgjithshëm për shpërndarjen e mjeteve. "Fillimi i zbatimit të masave do të jetë varësisht nga realizimi i të hyrave që vijnë në buxhet. Vendimi i parë do të jetë për vetë të punësuarit që janë larguar pa të drejtë nga përfitimi i mëhershëm prej 290 eurosh, do të jenë pastaj mjetet që ndahen për arsim e gradualisht ashtu si vijnë mjetet në buxhet do të merren edhe vendimet", tha Krasniqi.

Lidhur me shpërndarjen e këtyre mjeteve, "Radio Evropa e Lirë" ka kërkuar përgjigje edhe nga zyra e kryeministrit në detyrë e Kosovës, Avdullah Hoti, por nga kjo zyrë është thënë që lidhur me këtë çështje t'i drejtoheni Ministrisë së Financave.

Ndarja e 300 eurove për tre muaj për punëtorët të cilët kanë humbur vendin e punës ishte propozim i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Kjo parti, po ashtu, kishte propozuar edhe themelimin e një granti në shumën prej 200 milionë eurosh, ndihmë financiare bizneseve që janë prekur nga pandemia me Covid-19.

Të dyja këto propozime ishin futur në Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike, por që për të dy propozimet nuk janë ndarë fonde kur është bërë miratimi i buxhetit për vitin 2021.

## Punëtorët presin mjetet e premtuara

Në anën tjetër, Jusuf Azemi, kryetar i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, thotë për



"Radion Evropa e Lirë" se punëtorët po presin marrjen e këtyre mjeteve të premtuara dhe të përcaktuara edhe në Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Sipas tij, Qeveria e Kosovës duhet të gjejë forma dhe të kryejë këtë obligim.

"Presim formimin e komisionit dhe të fillojë aplikimi i atyre që kanë humbur punën gjatë pandemisë dhe të përfitojnë nga 300 euro për tre muaj", thotë Azemi. Ai ka shtuar se në bazë të të dhënave të tyre numri i personave që kanë humbur

punën gjatë pandemisë është rreth 100 mijë, por se mund të përfitojnë vetëm deri në 40 mijë, pasi ata janë të regjistruar si të punësuar, ndërkaq të tjerët nuk kanë pasur kontrata pune dhe nuk janë të regjistruar si të punësuar.

## Krasniqi: Jo më shumë se 10 mijë persona humbën punën gjatë pandemisë

Megjithatë, me këto shifra të Sindikatës së Sektorit Privat për numrin e punëtorëve që kanë humbur vendin e punës nuk pajtohet zëvendësministri në detyrë i Financave, Agim Krasniqi. "Nuk është aspak e vërtetë që thuhet se nga 40 mijë deri në 100 mijë punëtorë

e kanë humbur vendin e punës. Zyrtarisht ky numër është shumë më i vogël. Në Administratën Tatimore të Kosovës dhe Fondin Pensional tregojnë që ky numër është 10 herë më i vogël dhe kjo e dhënë e saktë zyrtare së shpejti do të publikohet nga

Agjencia e Statistikave e Kosovës", thotë Krasniqi. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka thënë se si rezultat i masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19, ekonomia e Kosovës do të shënojë rënie deri në 7.2 për qind.

## Nga muaji shkurt do të fillojë të paguhet pjesa tjetër e subvencioneve për bujqit

PRISHTINË, 10 JANAR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Musatafa, ka vizituar të dielën fermerët e Komunës së Malishevës. Ai ka premtuar mbështetje për ta. Mustafa gjatë vizitës në njërin nga pikat grumbulluese të qumështit në këtë komunë, ka thënë se nga muaji shkurt do të fillojë pjesa tjetër e pagesave për bujqit.

Ai ka thënë se, pavarësisht prej zhvillimeve politike, fondet për bujqit janë të garantuara, duke bërë me dije se pjesa tjetër e pagesave për bujqit dhe

blegtorët do të bëhet gjatë këtij viti, me fillimin e rialokimit të buxhetit. "Me kalimin e Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike dhe me kalimin e Ligjit për Buxhetin e vitit 2021, këto fonde janë të garantuara, pavarësisht çdo zhvillimi, këto janë të garantuara për bujqit, për blegtorët në gjithë Kosovën. Këto fonde do të fillojnë të paguhet në muajin shkurt. Ka mbetur edhe një pjesë e kështit të dytë për t'u realizuar dhe për të përfunduar të gjitha pagesat e vitit 2020", ka thënë ministri Mustafa.





# Hoxhaj në Anamoravë: Dy qeveritë e dështimeve nuk e ndërtuan asnjë autostradë

PRISHTINË, 10 JANAR (ER) - Kryetari i PDK-së, njëherësh kandidat për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka vizituar një pjesë të autostradës së Anamoravës, ku për muaj të tërë kanë ngecur punimet për ndërtimin e saj.

Hoxhaj ka kritikuar ish-qeverinë Kurti dhe Hoti për lënie pas dore të kërkesave të banorëve të Anamoravës dhe

të nevojave të Luginës së Preshevës për ndërtimin e autostradës, si njërin prej projekteve më të rëndësishme strategjike në këtë pjesë të Kosovës. "Ish-qeveritë Kurti e Hoti do të mbahen mend vetëm si qeveri të premtimeve dhe të dështimeve. As njëra e as tjetra nuk kanë mundur ta përfundojnë qoftë edhe një rrugë magjistrale e lëre më një

autostradë. Sot nga afër vizitova pjesë të mbetura në gjysmë të punimeve. Ky projekt i nisur nga PDK-ja ka mbetur ashtu i njëjtë meqë LV-ja e LDK-ja kanë interes për vota e jo për të kryer ndonjë punë", ka thënë Hoxhaj. Ai ka theksuar se në periudhën kur ka qeverisur PDK-ja në Kosovë janë ndërtuar dy autostrada të mëdha, Rruga e Kombit dhe autostrada "Arbën

Xhaferi" dhe se sapo ta marrë drejtimin e qeverisë, do ta përfundojë ndërtimin e autostradës së Anamoravës. "Partia Demokratike e Kosovës gjatë qeverisjes së saj ka investuar në infrastrukturë rrugore, si faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit duke ndërtuar dy autostrada. Ne e kemi nisur edhe ndërtimin e kësaj

autostrade dhe do ta përfundojmë pas 14 shkurtit, kur të jemi në krye të qeverisë. Unë i siguroj banorët e Anamoravës dhe ata të Luginës së Preshevës, se projekti i ndërtimit të autostradës Prishtinë - Gjilan - Dheu i Bardhë do të vazhdojë dhe është prioritet i programit tonë sa i përket infrastrukturës", ka thënë Hoxhaj.



## Kryeministri në detyrë: Do ta vazhdojmë mbështetjen e sektorit privat

PRIZREN, 10 JANAR (ER) - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka takuar përfaqësuesit e bizneseve në Komunën e Prizrenit, me të cilët ka zhvilluar një bashkëbisedim për t'i vlerësuar punët që janë bërë në vitin 2020, por edhe për t'u pajtuar për mbështetjen në vazhdim.

Në fjalën e tij, kryeministri Hoti tha se ka qenë një vit që do të mbahet mend për sfidat shëndetësore dhe ekonomike që i kemi kaluar gjatë pandemisë, e cila ka prekur çdo familje dhe biznes pa përjashtim.

Ai ka treguar se kanë pasur një program shumë të pasur sa i përket pjesës ekonomike dhe se fokusi kryesor gjatë vitit 2020 ka qenë të problemet ekonomike që ka sjellë pandemia.



Kryeministri Hoti foli edhe për Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike duke e quajtur si më të mirën në rajon e më gjerë. Hoti ka përmendur edhe miratimin e Ligjit për

Rimëkëmbje Ekonomike, i cili gjatë kohës sa është në fuqi deri në dhjetor të vitit 2021 tha se mundëson që të futen në ekonomi rreth 560 milionë euro në forma të ndryshme dhe se

janë duke i bërë përgatitjet për secilin dikaster që të fillohet zbatimi i tyre.

Ndër të tjera, ai tha se janë fokusuar shumë edhe në bujqësi, duke theksuar veçmas dyfishimin e subvencioneve, duke shtuar se me këtë dyfishim është arritur që të mbulojnë qind për qind koston e bizneseve në bujqësi.

Ai i njoftoi të pranishmit se janë në përgatitje të një pakoje të re fiskale e cila do t'i mbështesë bizneset. "Çështja e energjisë është shumë e ndjeshme. Ne kemi bërë të gjitha përgatitjet që gjatë vitit 2021 ta liberalizojmë komplet tregun e energjisë, ku bizneset që janë konsumuese të mëdha të energjisë elektrike të mund ta blejnë atë në tregun e lirë", ka deklaruar Hoti.

Ai nënvizoi se do ta zgjasin afatin e investimeve strategjike që ka mbaruar në dhjetor të 2020-s, si dhe do ta mbështesin fuqimisht fondin për garanci të kredive. Sa i përket marrëveshjes së Uashingtonit, kryeministri Hoti theksoi se kjo marrëveshje ekonomike e fuqizon Kosovën në aspektin politik dhe ekonomik, ku në aspektin ekonomik në katër vjetët e ardhshëm i sjell vendit rreth 1 miliard dollarë amerikanë investime.

Hoti ka thënë se ajo çfarë u intereson bizneseve është edhe siguria juridike, derisa i siguroi ata se para vetes kanë një qeveri që nuk i ndërron politikat e veta çdo natë, mbi të gjitha është qeveri e qendrës së djathtë, që nënkupton se e mbështet biznesin privat.

# Grushtshteti i turpit dhe Shqipëria



Bedri ISLAMI

Trump është një ndër ato raste të habitshme që vërteton se autokracia, arbitrariteti dhe hapja rrugë e së keqes një personi të vetëm mund të përpiqet ta kthejë historinë e një kombi, ta përmbysë në pak vite gjithçka është arritur dhe t'i manipulojë turmat duke bërë thirrje në emër të lirisë që, në fakt, nuk ka asgjë të përbashkët me lirinë që kanë ndërtuar dhjetëra breza.

Thirrja e ish-presidentit amerikan për ta sulmuar Kapitolin, e pashembullt në historinë amerikane, nuk erdhi në një qiell të pastër politik, krejt befaz dhe, si e tillë, ishte e çuditshme.

Gjithë rrugëtimi politik i Trumpit, që nga dita kur vendosi të jetë në luftën për pushtet, ka pasur dhjetëra e qindra prova se në

Shtëpinë e Bardhë sundon një njeri që nuk donte as paqe, as arsye, as lumturinë e njerëzve, por vetëm lista dëshirash që rridhnin nga halucinacionet, triumfe të paarsyeshme dhe aventura.

E fundit ishte sulmi mbi Kapitol, ku u përdhosën vlerat e disa shekujve dhe në të cilat prova të shumta dëshmuuan se edhe vetë ky shtet i madh ka probleme të mëdha, gjendje të lëvizshme politike, mllfe të grumbulluara në shumë vite, liri të cinguar dhe, të gjitha këto u shumëfishuan dhe u bënë të njohura në aferat e ish-presidentit, nga i cili po vrapojnë të distancohen të gjithë si nga një e keqe malarike. Por askush nga ato që tani janë të gatshëm ta linçojnë nuk bëjnë pyetjen e parë: përse e lejuam këtë?

Djallin e kryengritjes, ata, besnikët e tij, shpeshherë e veshën me pamjen e engjëllit të reformës, si njeriu që shkallmoi klasën e vjetër politike, pa menduar se një ditë do ta paguanin haraçin e nevojshëm.

Natyre melankolike, shpesh pre e anktheve, Trumpi e kaloi një pjesë

të jetës së tij, sidomos në çastet e pushtetit, në një gjendje ekstaze mistike, rob i emocioneve, i fryrë nga madhështia.

Përfundimi është kjo finale pushtetore, ku ish-presidenti nuk guxon të jetë i pranishëm as në përrurimin e presidentit të ri, çka nuk ka ndodhur asnjëherë më parë; ai trembet tani për fatin e tij personal, pasi ndryshe nga sa në Shqipëri, sistemi i drejtësisë atje nuk është vënë ende në këmbët e të parit të shtetit dhe ndien se si nga njerëzit rreth tij mendohet të kalohet në Amendamentin 25 të Kushtetutës, kur një presidenti të rrezikshëm si ai duhet t'i hiqen nga duart kompetencat, të shkarkohet nga detyra, duke pasur ndër mend se ai ka në duart e veta valixhen bërthamore, pa e ditur se ku mund të shkojë çmenduria e një njeriu.

Ka shumë përngjasime mes asaj që ndodhi në Kapitol, asaj që ka ndodhur në Shqipëri dhe asaj që mendohet se mund të ndodhë dhe, kjo e fundit, është përgatitur prej ditësh që të ndodhë.

1. Tentimi për grushtshtet përmes

një kryengritje është nxitur nga ish-presidenti Trump, thirrjet e të cilit jo vetëm asaj dite, për t'ju drejtuar Kapitolit nxiti më tej terroristët e ekstremit të djathtë për të përmbysur gjithçka, për të vënë nën pushtetin e tyre për disa orë tempullin amerikan të demokracisë, për të vandalizuar gjithçka dhe për të vënë në rrezik jetët e senatorëve dhe kongresmenëve amerikanë. Vandalizuesit kishin me vete armë të ndryshme, mjete shpërthyes, zjarrvënës, bomba molotov, që ishin të gatshme për përdorim.

Dy nga rastet më flagrante në Shqipëri kanë ndodhur në shtator 1998, kur bandat e ekstremit të djathtë, të sapolarguar nga pushteti dhe që nuk njihnin rezultatin e zgjedhjeve e humbjen e pushtetit, sulmuuan, pas thirrjeve të liderit të tyre, ndërtesën kryeministore, duke e pushtuar atë, duke vandalizuar gjithçka kishin përpara, për të shkuar më tej, në pushtimin e disa selive ministrore dhe ndërtesën e radiotelevizionit publik shqiptar, RTSh, që asokohe ishte i vetmi

medium viziv në Shqipëri. Që andej ata, përmes monarkistit Spahiu bënë thirrje për rrëzimin e pushtetit, se qeveria kishte rënë, se tani pushteti ishte në duart e tyre dhe nuk u zbrapsën nga policia dhe garda që, në fakt, ishte bërë pjesë e grushtshtetit, por nga ndërhyrja ndërkombëtare.

Asnjë nga organizatorët e grushtshtetit nuk u dënua; lideri i PD-së e ktheu selinë në një depo armësh dhe banditësh; edhe ata që u arrestuan, dolën "të pafajshëm" dhe vetëm me vonë, kur u larguan nga PD-ja treguan "mëkatën" e tyre.

Rasti i dytë, po aq dramatik dhe në sulmin ndaj selive pushtetmbajtëse është në çastet e rrëzimit nga pushteti të ish-kryeprokurorit të përgjithshëm Adriatik Llalla. Turmat e ekzaltuara nga dyshja Meta-Berisha sulmuuan godinën e parlamentit shqiptar për të pushtuar atë; duke e ditur se goditja e Llallës do të ishte fillimi i goditjes së aferave të tyre u bënë njëjtë si puçistët e shtatorit 1998, dhe, pas vrullit e mllëfit të tyre qëndronte përsëri lideri faktik i



opozitës, e cila, pasi nxori në radhët e para metingashët e çartur dhe të stimuluar, desh të ndizte gjithë vendin, ta përmbyste parlamentin, për të ruajtur një kryeprokuror, të cilin, vetëm një sistem drejtësie, si i yni, e lë të livadhisë përmes milionave latifondiste të përfituara edhe nga bashkëpunimi me krimin.

2. Një ngjashmëri tjetër, e cila dua të shpresoj se, pas këtyre ngjarjeve, nuk do të shkojë deri në fund.

Dihet tashmë se një grupim thellësisht radikal, i njohur si grupi Qanon, ishte në prirjen e gjithë tentimit për të përmbysur zgjedhjet dhe për të vendosur me dhunë se kush do të ishte presidenti i ardhshëm i Amerikës.

Ky grupim, me lidhje tejet të afërta me ish presidentin dhe i frymëzuar prej tij, kishte kohë që ishte përgatitur për të bërë këtë mënyrë dhe nuk e kishte fshehur qëllimin e tij. Mbështetja kryesore e tyre politike ishte ish-presidenti, por ka të dhëna se njerëz afër presidentit, me dijen ose jo të tij ishin edhe mbështetës financiarë.

Një strukturë të tillë ka krijuar prej kohe edhe opozita, e njohur si detashmenti i Azem Hajdarit, pjesë të së cilit, të uniformuar në

të zeza, njëloj si të organizatës "Sigurimi i atdheut" në Kosovë, një strukturë pro-shërbimit të fshehtë serb, janë shfaqur herë pas here, por që edhe tani, në mitingje të ndryshme, të pauniformuar, janë aktivë.

Krijimi i strukturave të tilla paramilitare janë të rrezikshme në çdo shtet, edhe kur ai duket i fuqishëm dhe i parrezikuar. Si ndodhi në SHBA, ku vërtet goditi forca e ligjit, por ku dëmi është aq i madh dhe humnera e hapur për demokracinë nuk do të mbyllet aq shpejt. Në Shqipëri është edhe më e rrezikshme, pasi themelet e shtetit përkulen shpejt dhe shumë media, antiqeveritare në momentin e parë të përmbysjes së Kapitolit u ngazëlluan, kishin shend dhe shpotitën ngjarjet duke sjellë ndër mend shpërndarjen e demonstratave në Shqipëri në kohën e ministrit Lleshaj. Disa nga personazhet e këtyre mediave, të lidhur ngushtë me qarqet e larta të opozitës prej kohe e dinë se në disa struktura të saj përgatiten skenarë të përmbysjes me dhunë në zgjedhjet e 25 prillit, e kjo jo vetëm përmes paralajmërimeve të Berishës apo të Metës, por edhe nga hollësitë që dinë për më tej se kaq.

Fakt është se paralajmërimet për zvarritje të liderit qeverisës, hedhje në lumin e Lanës, përsëritjen e vitit 1997, viti kob i Shqipërisë pluraliste me më shumë se 3200 të vrarë; thirrjet për linçime, përleshje, paralajmërimet presidenciale për dhunë dhe fshirjen e qeverisë - të gjitha këto gjoja në emër të mbrojtjes së Kushtetutës - njëjtë si Trump, nuk janë vetëm zhargavitje politike, por kanë pas vetes edhe struktura e njerëz të gatshëm për të bërë një tragjedi të re për hir të pushtetit.

3. Ish-presidenti amerikan Trump kishte kohë që kishte rrëshqitur, Deliri i tij i bashkuar me çastet halucionante kishin bërë vijën e qeverisjes së tij. Shenjat ishin dhënë. Njeriu që ishte thirrur për të mbrojtur kushtetutën e shtetit që drejtonte shtetbërëshembësi i saj.

Në Shqipëri kemi shembullin e presidentit të tanishëm. Është hera e parë që një president bën thirrje për të përmbysur qeverinë e ligjshme përmes dhunës së rrugës, që thërret, bashkë me opozitën, njerëzit në një meeting protestues, bën thirrje për revoltë, grumbullon rreth vetes "miqtë e Ilirit", si ndodhi në zgjedhjet e vitit 2017; shpërndan urrejtjen, sjell shembuj sakrificimi që çojnë drejt akteve ekstreme, si ai me Alende, Vojo Kushin e Avni Rustemin, kërcënon me shpërndarjen e parlamentit, kur e di fare mirë se nuk e ka këtë të drejtë, por kjo do të ndezë urat e zjarrit rreth të cilit ai do të ngrohë duart dhe do të fshehë pasurinë, delegon në Gjykatën Kushtetuese juristë që

nuk e meritojnë të jenë aty, por kanë shfaqur besnikërinë ndaj tij - të cilët as vetingun nuk e kanë kaluar, etj.

Një ditë atij mund t'i mbushet mendja të deklarojë shpërndarjen e parlamentit, mosdekreditimin e qeverisë, shembuj ka pasur në emërimin apo shkarkimin e ministrave; dhe të gjitha këto janë të njëjta si thirrjet e ish presidentit Trump për të sulmuar Kapitolin. Një ditë askush të mos çuditet, shenjat janë të plota. Pritet vetëm momenti i humbjes!

4. Në duart e presidentit amerikan Trump ishin grumbulluar, më saktë, kishte grumbulluar pushtete të mëdha, të cilat i zotëronte përmes arbitraritetit dhe autokracisë. Afera të mëdha do të jenë në ditët e ardhshme në dyert e gjykatave dhe sado që ai mund t'bëjë Falen e Vetes, asgjë nuk do të jetë e harruar.

Pushteti i tepërt në duart e një njeriu ka qenë gjithnjë premisa e parë e arbitraritetit. A po ndodh kjo edhe me shefin e tanishëm të qeverisë, Edi Rama? Pa dyshim, po.

Në duart e tij, nga vetë socialistët e trumhasur, është lënë një pushtet i pakufizuar, që vetëm Berisha e ka pasur.

Shumë gjëra, në një mandat të tretë, mund të shkojnë më tej. Opozita laramane dhe e heshtur, që nuk mbush dot boshllëkun e saj përmes llomotitjeve të Palokës, ku janë qepur pas edhe vegjetime politike si Ndoka, Shehi, Dule, të cilët presin ku është vendi i tyre në listë, dhe lehtësisht mund të kalojnë nga e djathta në të majtë, çka ka ndodhur me shumë prej tyre - përjashtuar Mediun, nuk mund të ndalojë arbitraritetin dhe autokracinë politike të liderit të Rilindjes.

Edi Rama nuk është i gatshëm për një grusht shteti për të ruajtur pushtetin e tij, por vitet e ardhshme në pushtet mund të krijojnë modelin e një lideri që, megjithëse ishte ndër të paktët publikisht kundër Trumpit në qeverisje, mund t'i ngjaj atij, nëse nuk mbushet në mend se arti i qeverisjes kërkon mbi të gjitha marrëveshje dhe dëgjim. Pushteti i tepërt dhe autokracia arbitrarë që shfaq herë pas here edhe lideri i Lëvizjes Vetëvendosje mund të dëmtojë nesër qeverisjen e tij.

Rruga e Kurtit drejt pushtetit dhe në pushtet, pas sprovës së parë, do të zgjasë shumë vite. Ky tashmë është një postulat i njohur. Ndërkohë ai ishte lideri i vetëm në Kosovë që mbështeti hapur përkrahjen ndaj presidentit aktual Biden, por edhe kjo duhet të jetë kujtesë në qeverisje. Mendimi vlen më shumë se gazrat lotsjellës dhe vizioni është më i pranueshëm se sa tymçet në sallën e parlamentit.

Jo çdo e keqe vjen vetëm për të keq.

Edhe kjo që ndodhi të mërkurën në Kapitoll do të ketë të mirat e saj!

# Partia Demokratike e Kosovës dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme 2021



Shkruan: Ismail SYLA

parë të saj, ish kryeministrit dhe ish presidentit Hashim Thaçi.

5. Përparësi e jashtëzakonshme e PDK-së në këto zgjedhje është fakti që liderët e saj në Hagë u goditën në pikën e tyre më të fortë, në nderin e tyre, në nderin e luftëtarit të lirisë dhe të njeriut çlirimtar.

6. Në kohën kur qëndruan në burgun e Hagës Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj në institucionet e Kosovës kishte germë dhe frymë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për dallim nga skena aktuale politike.

7. Aktualisht PDK-ja dhe aty këtu ndonjëri nga aleatët e saj janë e vetmja mbrojtje institucionale e lidërshiptit që padrejtësisht gjendet në burgun e Hagës. Përvetësimi dhe identifikimi me sloganin "Liria ka emër" i bën nder çdo subjekti politik.

8. Nuk i parapëlqej shprehjet ushtarake në përditshmërinë civile, por nuk ka si të mos thuhet se ka ardhur momenti i sprovës për t'u dëshmuar armata politike e Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit.

9. Me një PDK të fortë dhe stabile, janë stabilë dhe me plot imunitet politik liderët që sot gjenden padrejtësisht në Gjykatën e Hagës.


1. Partia Demokratike e Kosovës në zgjedhje e jashtëzakonshme të 14 shkurtit 2021 duhet ta dëshmojë forcën dhe vitalitetin e saj po ashtu të jashtëzakonshëm, si një parti me anëtarësi që ka bindje të thella dhe të bazuara në vlerat më të mira kombëtare, patriotike demokratike dhe institucionale.

2. Trashëgimia politike e Partisë Demokratike të Kosovës është historike. Ajo dhe lidërshipti i saj qëndrojnë në themelet e çlirimit dhe themelimit të Republikës së Kosovës, - shtet i pavarur dhe sovran.

3. Partia Demokratike e Kosovës është shquar vazhdimisht për anëtarësi të qëndrueshme. Edhe kur një pjesë e anëtarësisë nuk ka ndje dorën e të mirave dhe përfitimeve nga të qenit në PDK nuk ka lëvizur.

4. Arrestimet e nëntorit 2020 bëjnë që PDK të hyjë në këtë garë zgjedhore pa liderin Kadri Veseli dhe pa frymën universale të ish kryetarit të





EURO GLASS  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

# Bashkimi fiton derbin ndaj Prishtinës, Ponte e fortë për Trepçën



**PRISHTINË, 10 JANAR** - Bashkimi ka shënuar fitore në udhëtim ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 80:89 (24:18, 19:24, 14:23, 23:24), në kuadër të javës së 14-të të Prince Caffè Superligës së Kosovës në basketboll. Prishtina e nisi ndeshjen më mirë, me një seri prej 7:0, megjithatë, me kalimin e minutave Bashkimi kthehet në lojë, duke afuar rezultatit në 12:11, por, vendasit e përfundojnë çerekun e parë në të mirë të tyre 24:18. Prizrenasit ishin më të mirë në periudhën e dytë, ku kaluan në epërsi 29:30, dhe më pas zhvillojë një lojë e barabartë, ku pjesa e parë përfundon 43:42. Mysafirët e nisën më mirë pjesën e dytë, përkatësisht periudhën e tretë, ku kishin epërsi deri në 13 pikë, 47:60, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 57:65. Në 10 minutat e fundit, bardhekaltrit arrijnë të afrojnë rezultatit në

77:81, por pa arritur të bëjnë më shumë dhe Bashkimi triumfon në fund me rezultat 80:89. Te Sigal Prishtina u dalluan Meriton Ismaili me 18 pikë, Fisnik Rugova dhe Daniel Lekndreaj me nga 16 pikë dhe Seth Ladey me 13, kurse te Bashkimi më të mirët ishin Sean Hoehn me 22 pikë, Kevin Robinson me 19 pikë dhe Musab Mala me 17. Sigal Prishtina ka katër fitore dhe dhjetë humbje, kurse Bashkimi tetë fitore dhe gjashtë humbje. Ndërsa Ponte Prizreni ka shënuar fitore ndaj Trepçës me rezultat 95:74 (27:20, 19:22, 21:12, 28:20), në kuadër të javës së 14-të në Prince

Caffe Superligën e Kosovës në basketboll. Ponte Prizreni e nisi ndeshjen më mirë, duke kontrolluar lojën në fillim dhe e fiton çerekun e parë 27:20. Mitrovicasit ishin më të mirë në periudhën e dytë, ku me kalimin e minutave arrijnë të barazojnë shifrat dhe të kalojnë në epërsi 38:42, por një seri e vendasve prej 8:0, u mundëson që të shkojnë në pushim me shifrat 46:42. Pjesa e dytë ishte më e mirë për prizrenasit, që fitojnë periudhën e tretë, 21:12 dhe atë të fundit 28:20, duke triumfuar bindshëm në fund 95:74. Te Ponte Prizreni u dalluan Xavier Caneffax me 22 pikë e 10 asistime, Jeremiah Paige me 27 pikë, Arti Hajdari me 16 pikë dhe Joshua Martin me pesë pikë e 22 kërcime, kurse te Trepça më të mirët ishin Erving Walker me 26 pikë dhe Besnik Azemi e Dillon Smith me nga 13 pikë e tetë kërcime.

## SUPERLIGA

Ponte Prizreni - Trepça	95:74
Sigal Prishtina - Bashkimi	80:89
Rahoveci - Golden Eagle Ylli	92:86
Peja - Vëllaznimi	83:67

## SHKURT

### Rugji konfirmon ndarjen me Ballkanin

Portieri Armend Rugji e ka zyrtarizuar largimin nga skuadra e Ballkanit të Suharekës. Portieri në fjalë ka falënderuar drejtuesit e klubit, tifozët dhe gjithë qytetin e Suharekës për kohën e kaluar së bashku. "Dua t'i falënderoj nga zemra 'Xhebrailat' dhe qytetarët e Suharekës për përkrahjen që më kanë dhënë për katër vjet sa kam qenë pjesë e klubit. Faleminderit shumë Arsim Kabashit dhe Bali Kabashit! Faleminderit Suharekë!", ka shkruar Rugji në profilin e vet në "Facebook".

### Shaqiri largohet nga Arbëria

Mesfushori i njohur Filonit Shaqiri është larguar edhe zyrtarisht nga skuadra e Arbërisë nga Dobroja. Mesfushori që ka luajtur në të kaluarën edhe për Gjilanin nuk ka dhënë hollësi të tjera rreth të ardhmes së tij. "Ju bëj me dije se e kam përfunduar bashkëpunimin me Klubin e Futbollit 'Arbëria' dhe tashmë jam një futbollist i lirë. Shfrytëzoj rastin t'i falënderoj drejtuesit e këtij klubi për korrektësinë dhe stafin teknik për besimin", ka thënë Shaqiri.

### Mustafi refuzon Genoan

Shkodran Mustafi ka refuzuar kalimin te klubi i Serisë A të Italisë, Genoa, raporton "Calcio Mercato". Mbrojtësi 28-vjeçar i Arsenalit është duke kërkuar klub të ri në këtë afat kalimtar, ndërsa po u afrohet gjashtë muajve të fundit të kontratës së tij. Genoa është interesuar për Mustafin, por mbrojtësi shqiptar nuk e ka pëlqyer idenë e transferimit te ky klub. Mustafi tek Arsenalit po shihet tepriçë.

### Bytyqi asiston në debutimin për Konyasporin

Zymer Bytyqi ka shkëlqyer në ndeshjen e parë debutuese te skuadra e re Konyaspor. 24-vjeçari u transferua më herët gjatë muajit nga skuadra norvegjeze Viking dhe ka arritur menjëherë ta bëjë dallimin për skuadrën e re. Edhe pse skuadra e tij humbi, ai regjistroi një paraqitje të mirë. Pas 10 minutash nga inkuadrimi, dhuroi një asistim në minutën e 84-t për Jevtoviçin.

### Kiqina nënshkruan kontratë profesionale me Feronikelin

Sulmuesi nga akademja e FC Feronikelit, Sokol Kiqina, ka nënshkruar kontratë profesionale me skuadrën e parë të Feronikelit. Kiqina ka kohë që stërvitet me ekipin e parë dhe e ka bindur kryetrajnerin Klodian Duro që ta ketë edhe zyrtarisht pjesë të ekipit të parë. Kiqina tashmë ka dy paraqitje me FC Feronikelin, duke arritur të realizojë një gol në ndeshjen e Kupës së Kosovës. Kiqina luan në pozitën e qendërsulmuesit, por mund të luajë edhe në pozita të tjera sulmuese. "Duro ka kohë që bashkëpunon fuqishëm me akademinë e FC Feronikelit, duke ofruar gjithnjë lojtarë të rinj me ekipin e parë, duke i dhënë mundësinë secilit që të dëshmojë", thuhet në njoftimin e "Niklit".

## Idrizi: Trepça '89 synon mbijetesën dhe Kupën

**MITROVICË, 10 JANAR** - Trajneri i Trepçës '89, Shpëtim Idrizi, ka folur për faqen zyrtare të klubit. Ai ka deklaruar se në skuadër mund të arrijnë 3-4 përforcime, teksa ëndërojnë ta prekin finalen e Kupës së Kosovës. "Kemi filluar stërvitjet. Më gëzon

fakti që futbollistët, përkundër pushimit, janë në gjendje të mirë fizike. Do të mundohemi që fazën e parë dhe të dytë ta përfundojmë në Mitrovicë e pastaj në fazën e tretë të aranzhojmë ndeshje miqësore për të punuar në pjesën tekniko-

praktike dhe ta përdorim atë fazë për adaptimin e përforcimeve eventuale", ka thënë Idrizi. "Kemi përbërje të re dhe premtuese. Na duhet koordinim dhe adaptim me lojën tradicionale që e bën skuadra. Synojmë 3 deri në 4 emra të rinj

për ta shtuar konkurrencën dhe cilësinë. Synimi ynë është pjesa e epërme e renditjes dhe largimi nga zona e rrezikshme, ndërkohë synojmë që në Kupë të shkojmë sa më lart dhe nëse jemi me fat, ta arrijmë edhe finalen", ka shtuar Idrizi.



## Asamble sekrete në KOKSh, shkarkohet presidenti Bezhani

**TIRANË, 10 JANAR** - Rrufe në qiell të hapur, mund të konsiderohet ajo që ndodh në KOKSh. Përmbytjet e këtyre ditëve kanë sjell pasojë edhe në olimpizmin shqiptar, që ka të drejtën të mblidhet dhe ta organizojë Asamblenë e Jashtëzakonshme në periudhë pandemie kur nuk lejohen grumbullimet. Asgjë për t'u çuditur kur flitet për KOKSh, ku skandalet kanë qenë të njëpasnjëshme dhe janë kthyer në një normalitet. Më shumë se sa për sport, është folur për çështje të tjera dhe kryefjalë kanë qenë prokuroria dhe gjykata. Kjo e fundit do të ketë sërish punë, pasi sot u mblodh Asambleja e Jashtëzakonshme, me kërkesë të 2/3-ve të anëtarëve, siç edhe e parashikon Statuti. Gjithçka ka ndodhur në fshetësi të plotë, pa asnjë njoftim për mediat. Zakonisht asambletë kanë qenë të hapura dhe janë transmetuar direkt në rrjetet sociale. Këtë herë nuk ka ndodhur dhe në Asamblenë e Jashtëzakonshme kanë kaluar për votim ndryshimet statutores. Tri ishin ndryshimet që ishin kërkuar, por nuk kanë



gjetur mbështetje. Një prej pikave më të nxehta ishte që të përjashtoheshin nga kandidimi i personave të përfshirë në politikë në pesë vjetët e fundit. Kjo pikë prekte drejtpërdrejt deputetin Fidel Ylli, i cili besohet se do të jetë kandidat për president të KOKSh. Po sot, në Asamblenë e Jashtëzakonshme është vendosur që të shkarkohet presidenti Viron Bezhani, me 45 vota për dhe 9 kundër, raporton "abcnews". Këto ndryshime në Statut duhet të kalojnë në gjykatë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit

dhe Rinisë. Bezhani është kundër kësaj që ka ndodhur dhe çështjen do ta çojë në gjykatë. Mbetet të shihet nëse njyja e KOKSh do të zgjidhet njëherë e mirë, apo do të vazhdojë lëmshi i zakonshëm që kryefjalë ka akuzat. Diçka tjetër e çuditshme në Asamblenë e Jashtëzakonshme të zhvilluar sot ishte edhe fakti që në të nuk merrnin pjesë as presidenti Viron Bezhani, as sekretari i përgjithshëm Stavri Bello dhe as përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

## San Antonio triumfon kundër Minnesotas, fitojnë edhe Dallasi e Miami

**MINNESOTA, 10 JANAR** - San Antonio Spursi vijon ngjitjen në renditje, pasi ia doli ta regjistrojë fitoren e tretë radhazi, këtë herë me shifrat 122-125, por vetëm pas luajtjes së kohës shtesë në transfertën ndaj Minnesota Timberwolvesit në "Target Center". Sfida ishte e balancuar me të dy skuadrat që fituan nga një set dhe në fund të kohës së rregullt rezultati ishte i barabartë 113-113, ndërsa Spursi fitoi me tri pikë diferencë në kohën shtesë. Dëmar DeRozan ishte protagonist absolut për San Antonion, pasi ia doli të shënojë 38 pikë, t'i rikuperojë 5 topa dhe të japë 5 asistime, ndërsa te Minnesota u paraqitën mjaft mirë Beasley dhe Towns. Washington Wizardsi pësoi humbjen e 8 në 10 ndeshjet e para sezonale, teksa këtë herë u dorëzua përballë Miami Heatin në "Capital One Arena". Miqtë nga Miami u shfaqën dominues



në tri fraksionet e para, ndërsa Wizardsi u zgjua në pjesën e fundit të cilën e fitoi me rezultat të thellë, por nuk ia doli ta përmbysë rezultatin. Tyler Herro dhe Jimmy Butler ishin protagonistët e suksesit për Miami Heatin, pasi të dy bashkë arritën të shënojnë 57 pikë, të rikuperojnë 19 topa dhe të japin 11 asistime. Vijnë të bëjë mjaft mirë në këtë fillim sezoni edhe Dallas Mavericksi që triumfoi me shifrat 112-98 në "Airlines

Center" përballë Orlando Magicut. Tim Hardaway Jr ishte protagonist absolut për suksesin e Dallasis, pasi shënoi 36 pikë, rikuperoi 5 topa dhe dha dy asistime. Në ndeshjet e tjera, Portland Trail Blazersi triumfoi me shifrat 99-125 në transfertën ndaj Sacramento Kingsit, i udhëhequr edhe nga CJ McCollum me 37 pikë, ndërsa Milwaukee Bucks i mposhti me rezultatin 100-90 skuadrën e Cleveland Cavaliersit.

### SHKURT

#### Koeman: Na nevojitet Messi për të fituar tituj

Barcelona e mposhti Granadan në udhëtim me rezultat bindës 0-4 falë Messit dhe Griezmannit, të cilët realizuan nga dy gola. "Ringjallja" e Messit ka lumturuar edhe trajnerin e Barcelonës, Ronald Koemanin, i cili ka thënë se ekipi ka nevojë për argentinasi për të fituar tituj. "Lufta për titull duhet të jetë mentaliteti i skuadrës. Ekipi po përmirësohet shumë, kishim tri ndeshje jashtë shtëpisë dhe kemi arritur 9 pikë. Ne jemi më shumë të qetë dhe ishim më shumë të koncentruar. Ju duhet të jeni të përlulur dhe të vazhdoni të punoni për të përmirësuar. Ishte e rëndësishme ta mbanim portën e paprekur. Kemi nevojë për Leo Messin në mënyrë që të fitojmë tituj", ka thënë Koeman.

#### Japonezët duan që Lojërat Olimpikë të anulohen ose shtyhen

Rreth 80 për qind e njerëzve në Japoni thonë se Lojërat Olimpikë në Tokio, të parapara të mbahen këtë vit, duhet të anulohen apo shtyhen, nga shqetësimi për rritje rekorde të rasteve me koronavirus, sipas një ankete të bërë nga Kyodo News. Në anketën 35.3 për qind kanë kërkuar që Lojërat Olimpikë të anulohen, ndërsa 44.8 për qind që të shtyhen sërish. Ngjarja më e madhe sportive ishte shtyrë vitin e kaluar shkaku i pandemisë. Ngjarja është paraparë të mbahet nga 23 korriku deri më 8 gusht. Kryeministri i Japonisë, Yoshihide Suga, e ka shpallur gjendje emergjente në Tokio të enjten dhe mund të shtrijë këto masa edhe në zonat e tjera në Japoni.

#### Dembele, afër Atletico

Sulmuesi francez Moussa Dembele është shumë pranë transferimit te skuadra e Atletico së Madridit, teksa konfirmimin e ka dhënë vetë drejtori sportiv i Lyonit, braziliani Juninho. Në një intervistë për mediat franceze, në prag të ndeshjes në transfertë ndaj Nimes, Juninho ka thënë se negociatat me klubin spanjoll janë në fazë të avancuar dhe se nëse vetë 24-vjeçari do të pranojë transferimin. "Ka një mundësi që Moussa Dembele të largohet gjatë merkatos së janarit. Jemi në fazë të avancuar negociatash me Atletico e Madridit dhe nëse edhe futbollisti do të pranojë, atëherë gjithçka do të mbyllet me sukses", ka thënë ai. Dembele ka nisur sezonin e tretë me fanellën e Lyonit dhe në 105 ndeshje ka shënuar 45 gola, ndërsa tek Atletico e Madridit pritet ta marrë vendin e Diego Costës së larguar pak ditë më parë dhe të luajë në krah të Luis Suarezit.

#### Zidane, pas barazimit ndaj Osasunës: Nuk ishte ndeshje futbollit

Spanja është goditur nga stuhia Filomena dhe një pjesë e mirë e vendit është mbuluar nga dëbora, ndërsa shumë ndeshje futbollit u shtynë. Në mesin e tyre nuk ishte sfida e Osasunës ndaj Realit. Trajneri Zidane ka mbetur shumë i pakënaqur teksa, sipas tij, sfida duhej të shtyhej. "Mendoj se për kushtet atmosferike, ky takim duhej të shtyhej. Qëndruam tri orë në ajër, në pritje për t'u ulur dhe më pas luajtëm në kushte shumë të vështira. Kjo nuk ishte aspak një ndeshje futbollit, ndaj nuk më intereson as rezultati. Nuk ishin as kushtet më minimale për të luajtur një ndeshje futbollit si për ne, ashtu edhe për kundërshtarët. Na kanë thënë se aeroporti i Madridit është i mbyllur përkohësisht për shkak të dëborës dhe do të vijojmë të qëndrojmë këtu. Shpresoj që të kthehem të hënën, pasi të mërkurën kemi një ndeshje tjetër dhe nuk kemi aspak kohë për t'u përgatitur", ka thënë Zidane.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërrhurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI



**AGRON SHALA**

**DEKALOGU**

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



ISBN 978-9951-780-37-7

9 789951 780377



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4<sup>99</sup> €



ISBN 978-9951-780-10-0

9 789951 780100

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

**Daut Dauti**  
**NJË PALË KËPUCË NË BERLIN**

novelë







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

